



Mbrojtësi i kombëtares shqiptare, Elseid Hysaj është në listën e lojtarëve të rinj më të mirë të kampionatit evropian France 2016. Hysaj është 22 vjeç dhe ka filluar karrierën e tij futbollistike me të rinjtë e Vllaznisë, për tu transferuar në Itali tek Empoli.

Ai është thirrur që herët me ekipet kombëtare të U-17, U-19, U-21 dhe sëfundmi lojtar i formacionit baze me De Biasin.

Në krahun e majtë ai ka treguar, pavarësisht moshës së re që ka, se është një lojtar kyç jo vetëm i kombëtares tonë por edhe në ekipin e tij Napoli.

Hysaj është zgjedhur në listën për lojtarët e rinj më të mirë nga një grup ekspertësh të futbollit mes të cilëve është Alex Ferguson apo David Moyes. Në listën për lojtarin më të mirë bëjnë pjesë edhe Sanches i Portugalisë, i cili në ndeshjen e mbremshme shënoi gol, apo edhe Kimmich i Gjermanisë, Milik i Polonisë, Duda i Sllovakisë, etj.

Hysaj në këtë evropian ka luajtur në të 3 ndeshjet që kombëtarja jonë ka zhvilluar duke u paraqitur majft mirë.

Kriteret e vlerësimit për lojtarin e ri më të mirë janë:

- Aftësi të jashtëzakonshme në sulm ose në mbrojtje.
- Përfshirja në veprime vendimtare në sulm ose në mbrojtje.
- Pjekuri taktike dhe efikasitet gjatë aktivizimit në ndeshje.
- Një qëndrim fair-play gjatë Euro 2016.

Lojtari i ri më i mirë do të shpallet në përfundim të kampionatit France 2016.